



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1151/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Hasan Maxhunit anetare i AAK-se dega ne Vushtri, konkretisht kandidat per asamble komunale te Komunes se Vushtrise paraqitur kunder Komisionit Qendror te Zgjedhjeve (KQZ) pas shpalljes se rezultateve perfundimtare per kuvend komunal për shkak të parregullsive gjate procesit zgjedhor dhe Manipulimit te votave , në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Hasan Maxhunit kandidat per kuvendin komunal te Vushtrise nga rradhet e AAK-se dega ne Vushtri.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 03.12.2013 ka pranuar një ankesë nga Hasan Maxhuni anetare e subjektit politik te AAK-se, konkretisht kandidate per asamble komunale te Komunes se Vushtrise në të cilën pretendon se ka dyshime se ne qendren e votimit nr 2708b iu jane bere padrejtesi pasi qe ka pasur votues e konfirmoj edhe vota, por sipas komisionereve te ketyre vendvotimeve iu eshte thene se jane prishur 106 vota ose i jane devijuar kah anetaret e afert te ketyre komisionereve dhe kerkoj numriin e ketyre votave te ketij venvotimi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se nga deshmita e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe nga pretendimet e ankuesit në ankesën e tij se ka ndodhur manipulimi i votave gjate procesit zgjedhor , vlersohen si te pabazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse, siç pretendon pala ankuese në ankesën e saj, andaj ankesa e tillë është e pabazuar dhe se për këtë çështje PZAP-i në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe dhe nenit 3.6.pika c. vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1151/2013 më datën 06.12.2013



Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani

Këshillë Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*